



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:095989

Datë: 23.10.2024

Numri i dokumentit: 06341200

KPPP.nr. 574/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.R.M “Ekoregjioni” Sh.A., me numër unik identifikues 811324152, me seli në Prizren, rr. “Tahir Sinani”, nr.59, kundër debitorit M.I. B.I me numër unik identifikues 810288549 dhe seli në Brodosanë, Komuna Dragash, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 232/24, i lejuar me datë 01.03.2024, nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani, me seli në Suharekë, jashtë seancës, me datë 23.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit M.I. B.I, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 232/24, i lejuar me datë 01.03.2024, nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani, për borxhin në shumë prej EUR 845.78 dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit M.I. B.I., ashtu që pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 232/24, i lejuar me datë 01.03.2024, nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani, sa i përket borxhit në shumë prej EUR 255.04, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm kartela e konsumatorit 2010- B306204BRO, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 232/24, të datës 01.03.2024, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 1,100.82, për periudhën deri më datë 16.01.2024, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se debitori nuk ka lidhur kontratë për mbledhjen e mbeturinave me kreditorin, ndërsa borxhi i pretenduar është përfshi në parashkrim në kuptim të dispozitave të LMD-së. Për këto arsye debitori i ka propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se e kundërshton prapësimin e debitorit sepse urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm, ndërsa ka shtuar se kreditori ka për obligim që në tërë territorin të kryej shërbimin e mbledhjes së mbeturinave dhe rrjedhimisht debitori nuk ka bazë të thirret në mos kontraktim të shërbimit, ngase tarifat obligative rezultojnë nga fakti se debitori është banor rezident në një hapësirë të caktuar. Ndërsa sa i përket referimit të parashkrimit të kërkesës që ka bërë debitori, kreditori ka theksuar se në rastin konkret debitori është biznes e që parashkrimi i kërkesës në këto raste është tre vite. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.2 e të njëjtit nen përcakton ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokumente të besueshme sipas së cilave mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht ekstraktin e verifikuar nga librat afarist i cili i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, meqenëse në ekstrakt janë

treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitorit, janë përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Ndërsa, pas vlerësimi të pretendimeve të debitorit lidhur me afatin e parashkrimit, gjykata ka shqyrtuar ekstraktin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në raport me faturat e përfshira ekstrakt dhe në mbështetje të dispozitave nga 355 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Sipas nenit 355.1 të LMD-së, *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*. Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat e përfshira në ekstrakt deri me datën 28.02.2021, në shumën prej EUR 845.78 kanë arritur afatin e parashkrimit, ngase propozimi për përmbarim nga ana e kreditorit në raport me faturimet për këtë periudhë kohore është paraqitur me datë 01.03.2024, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes për pagesë.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12.2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit, duke përfunduar procedurën përmbarimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 845.78.

Ndërsa, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit përmbarimor për detyrimin në lartësi EUR 255.04, pasi që kjo pjesë e detyrimit nuk është përfshi në parashkrim në kuptim të nënti 355 të LMD-së, ndërsa ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri për këtë pjesë të detyrimit i përmban të gjitha elementet për të shërbyer si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit

13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.574 /24, datë 23.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.